



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislacioni -III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 04-2008

Prishtinë, më 7 mars 2008, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C- 203

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Selvije Halimi, Bajram Kosumi, Kolë Berisha, Riza Smaka, Adem Hajdaraj, Džezair Murati.

Munguan: Branisllav Grbiq, Melihate Tërmkollli.

Të ftuarit: Lumnije Murati-ZPK, Ramadan Islami-OSBE, Lejla Selimi-OSBE, Petrit Hysaj-OSBE, Reshit Gashi-NDI, Haxhi Gashi-USAID, Robert Steere-NCSC, Fitore Zeneli-KDI.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Drita Çarkaxhiu, Behlul Zeka.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit, me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi i projektligjeve për bazën juridike në Kornizën Kushtetuese
3. Shqyrtimi i Projektligjit për deklarin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë
4. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës dhe gjithashtu propozoi që nën pikën të ndryshme të diskutohet në lidhje me çështjen e zgjedhjes së Ombudspersonit.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i projektligjeve për bazën juridike në Kornizën Kushtetuese

Bahri Hyseni-kryetar i Komisionit, theksoi se Kuvendi ka shqyrtuar 18 projektligje dhe se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi duhet të diskutojë për bazën e tyre juridike. Së pari Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Kooperativat e Bujqve, nr. 2003/9 dhe Projektligji për Inspektoratin e Bujqësisë, baza e tyre juridike është në kreun 5.1. (j) të Kornizës Kushtetuese.

Të dy projektligjet u miratuan njëzëri nga anëtarët e Komisionit.

Dy projektligjet e tjera ishin Projektligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe Projektligji për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, baza e tyre është në kreun 5.2 (a) të Kornizës Kushtetuese.

Riza Smaka-Tha se nuk pajtohet që të miratohet Projektligji për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, sepse me këtë shkelen parimet themelore, u jepet primat ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Kryetari-Tha se ne duhet ta shqyrtojmë bazën juridike, ndërsa Komisioni përkatës është kompetent për ta ndryshuar emrin e tij.

Selviqe Halimi-Theksoi se Ligji ka vepruar deri më tash, ndërsa nga ne kërkohet plotësimi dhe ndryshimi i tij, si dhe shqyrtimi i bazës juridike.

Projektligji për parandalimin e pastrimit të parave u miratua njëzëri.

Projektligji për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme u miratua me shumicë. Deputeti, Riza Smaka, votoi kundër miratimit të këtij projektligji.

Vijoi shqyrtimi i Projektligjit për vlerësimin strategjik mjedisor, që e ka bazën në kreun 5.1 (f), të Kornizës Kushtetuese, i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale, i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për inspektoratin e punës, i Projektligjit për përkrahjen materiale të familjeve dhe të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme dhe i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, që e ka bazën në kreun 5.1. (g).

Pesë projektligjet u miratuan njëzëri nga anëtarët e Komisionit.

Projektligji për ushqimin, që e ka bazën juridike në kreun 5.1.(l), Projektligji për provimin përfundimtar dhe të maturës, që e ka bazën në kreun 5.1 (d), Projektligji për

taksën e vendosjes, që e ka bazën në kreun 5.1 (II) dhe Projektligji për tokën ndërtimore, privatizimin dhe dhënien me qira të tokës ndërtimore, që e ka bazën në kreun 5.1. (I).

Katër projektligjet u miratuan njëzëri nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari-Theksoi se pas shqyrtimit të këtyre projektligjeve në komisionet përkatëse, mund t'i kthejmë edhe një herë pasi të jenë amendamentuar, në komisionet përkatëse.

Adem Salihaj-Theksoi se në raste të ndryshme ne si deputetë nuk duhet të ngurrojmë për të marrë individualisht ndonjë projektligj dhe ta japim kontributin tonë për projektligje të caktuara të komisioneve referuese.

Pas shqyrtimit të kësaj pike:

Komisioni vlerësoi se projektligjet e lartcekura kanë bazë juridike në kreun 5.1. të Kornizës Kushtetuese dhe rekomandoi që këto projektligje të procedohen për shqyrtim të mëtutjeshëm dhe për miratim në një nga seancat e Kuvendit.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

Kryetari-Tha se duhet ta caktojmë një raportues për Projektligjin për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë. Riza Smaka u caktua raportues për këtë projektligj.

Njëzëri u pajtuan që raportues për këtë projektligj të caktohet Riza Smaka.

4. Të ndryshme

Kryetari-Theksoi se duhet të organizohen dëgjime publike për Projektligjin për procedurën kontestimore, për Projektligjin për procedurën jokontestimore dhe për Projektligjin për procedurën përmbarese. **Riza Smaka**-Tha se me rastin e amendamentimit të projektligjeve duhet të angazhohen ekspertë të jashtëm, profesorë universitarë dhe njohës të mirë të këtyre çështjeve. Ai më tutje shtoi se duhet gjithashtu të gjendet mundësia e pagesës për shërbimet që i ofrojnë ata.

Kryetari-Tha se duhet të formohen grupet e punës dhe në rastet kur duhen ekspertë ne do t'i angazhojmë, për shembull me rastin e projektligjeve vëllimore siç është Projektligji për noterinë, ne do të ftojme ekspertë edhe pse buxheti është shumë i kufizuar, por për këtë projektligj duhet të angazhohen së paku dy ekspertë.

Selviqe Halimi-Propozoi që të caktohen datat për organizimin e dëgjimeve publike, sepse duhet të rezervohet salla. Ftesat dhe materialet duhet të dërgohen pesë ditë para dëgjimit.

Pas diskutimeve për këtë pikë, Komisioni vendosi që datat për mbajtjen e dëgjimeve publike të caktohen brenda javës së tretë dhe të katërt të muajit mars.

Zgjedhja e Ombudspersonit

Kryetari-Theksoi se është shpallur sërish konkursi për pozitën e Ombudspersonit dhe Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, gjithashtu, është përgjegjës për intervistimin e kandidatëve që do aplikojnë për këtë pozitë. Ai më tutje propozoi që javën e ardhshme të formohet një Komision në lidhje me këtë çështje dhe kërkoi nga stafi mbështetës i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, që në mbledhjen e së martës t'i sigurojë rregullat e miratuara në Kuvendin e Kosovës, si dhe shpalljen e konkursit.

Propozimi u miratua njëzërit.

Kryetari i falënderoi edhe një herë të pranishmit dhe e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 11:05.

Procesverbalin e hartoi:
Behlul Zeka, zyrtar ligjor

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni